RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10352, DATË 18.11.2010, "PËR ARTIN DHE KULTURËN", I NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet përmirësimi dhe modernizimi i kuadrit ligjor që rregullon fushën e artit dhe kulturës, duke përcaktuar në mënyrë më të qartë objektin, subjektet dhe fushën e zbatimit të tij, si dhe duke përditësuar konceptet dhe përkufizimet ligjore në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të sektorit kulturor. Projektligji synon të njohë dhe të përfshijë në mënyrë më të plotë diversitetin e veprimtarisë artistike dhe kulturore, duke zgjeruar fushat e mbuluara prej tij me forma të ndryshme të krijimtarisë, si artet pamore, të aplikuara, skenike, performuese dhe muzikore, kinematografia, letërsia, krijimtaria audiovizuale dhe digjitale, veprimtaritë muzeore, bibliotekare dhe arkivore, si dhe format e tjera multidisiplinare të shprehjes artistike dhe kulturore.

Një objektiv i rëndësishëm i projektligjit është qartësimi i kategorive të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e artit dhe kulturës, nëpërmjet përcaktimit më të plotë të koncepteve të artistit, profesionistëve të kulturës dhe subjekteve private që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë. Në këtë drejtim, synohet krijimi i një kuadri ligjor më të qartë për njohjen e formave të ndryshme të angazhimit dhe ushtrimit të veprimtarisë artistike e kulturore, pavarësisht formës së organizimit, marrëdhënies së punësimit apo mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë, në mënyrë individuale ose në bashkëpunim me persona të tjerë. Gjithashtu, përditësimi i përkufizimeve të cilësisë artistike, prodhimit artistik, projektit artistik, skenës së pavarur kulturore dhe veprës së artit synon të krijojë një bazë konceptuale më të qartë për zbatimin e dispozitave të ligjit dhe për njohjen e formave bashkëkohore të krijimtarisë.

Një tjetër objektiv është zgjerimi dhe qartësimi i fushave të veprimtarisë artistike dhe kulturore, duke përfshirë jo vetëm format tradicionale të shprehjes artistike, por edhe veprimtaritë bibliotekare dhe arkivore me karakter kulturor,

dokumentar, kërkimor, edukativ dhe promovues, veprimtaritë e institucioneve muzeore që lidhen me koleksionet e artit, si dhe veprimtaritë që lidhen me identifikimin, dokumentimin, interpretimin, transmetimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore jomateriale, folklorit dhe traditave të gjalla. Në këtë kuadër, përfshihen gjithashtu veprimtaritë kërkimore-shkencore, kuratoriale, edukative, formuese dhe profesionale, duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi dhe kompetencat e institucioneve përkatëse.

Projektligji synon gjithashtu zgjerimin e kategorive të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përfshirë shprehimisht Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, si dhe institucione të tjera publike qendrore të krijuara me ligj ose akt nënligjor, që ushtrojnë funksione në fushën e artit dhe kulturës. Në të njëjtën kohë, parashikohet që për institucionet organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohen me ligje të posaçme, dispozitat e këtij ligji të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të posaçëm përkatës.

Një objektiv i rëndësishëm i projektligjit është forcimi i rolit, funksioneve dhe kapaciteteve të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përcaktuar më qartë misionin e tyre publik dhe funksionet që ato ushtrojnë në përmbushje të interesit publik dhe politikave kombëtare të zhvillimit kulturor. Në këtë drejtim, synohet garantimi i ushtrimit të veprimtarisë së tyre mbi bazën e parimeve të autonomisë profesionale dhe artistike, lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmit artistik, aksesit publik, transparencës, profesionalizmit, diversitetit kulturor dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit. Gjithashtu, parashikohen funksione që lidhen me zhvillimin e praktikave të reja artistike, kërkimin, eksperimentimin dhe inovacionin, edukimin kulturor, zhvillimin e audiencave, ndërmjetësimin kulturor, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe digjitalizimin dhe ruajtjen afatgjatë të koleksioneve kulturore e dokumentare.

Në këtë drejtim, projektligji synon edhe përmirësimin e mekanizmave të drejtimit dhe funksionimit të institucioneve, përmes qartësimit të rolit të bordeve artistike dhe njohjes së mundësisë së funksionimit të organeve të tjera kolegjiale me funksione këshillimore apo profesionale, sipas statutit të institucionit dhe legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, përcaktohet më qartë procedura e miratimit të rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm të institucioneve publike të artit dhe kulturës, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për

artin dhe kulturën, me propozimin e titullarit të institucionit përkatës, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon një procedurë tjetër. Parashikohet gjithashtu që statuti dhe rregullorja e institucionit të mos krijojnë kompetenca, funksione ose detyrime financiare që nuk parashikohen në ligj ose në aktin e krijimit të institucionit.

Projektligji parashikon gjithashtu rishikimin e përbërjes dhe procedurës së emërimit të anëtarëve të bordeve artistike, duke përcaktuar një përbërje prej shtatë anëtarësh, ku përfshihen përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, si dhe pesë personalitete të shquara të fushës së artit ose të veprimtarive shoqërore që lidhen me të. Për këta të fundit, parashikohet që emërimi të bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, mbi bazën e propozimeve të titullarit të institucionit përkatës, i cili paraqet të paktën tri kandidatura për çdo pozicion anëtari. Gjithashtu, përcaktohen rregulla për papajtueshmërinë e anëtarësisë me punësimin në institucionin pranë të cilit funksionon bordi, kohëzgjatjen katërvjeçare të mandatit, të drejtën e riemërimit dhe procedurën e zëvendësimit në rast të mbarimit të parakohshëm të mandatit. Këto parashikime synojnë të forcojnë përfaqësimin profesional, transparencën dhe funksionimin e qëndrueshëm të organeve kolegjiale.

Gjithashtu, projektligji synon të përmirësojë sistemin e financimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke zgjeruar burimet e të ardhurave dhe duke përcaktuar mekanizma më të qartë për administrimin, përdorimin dhe monitorimin e tyre. Burimet e financimit përfshijnë financimet nga Buxheti i Shtetit për shpenzimet operative, administrative, investimet dhe pajisjet teknike, financimet për repertorin vjetor dhe veprimtaritë artistike e kulturore, të ardhurat nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave, shitja dhe shfrytëzimi ekonomik i veprave artistike e kulturore, shërbimet bibliotekare, bibliografike, dokumentare dhe digjitale, financimet e përfituara nga programe dhe projekte, sponsorizimet, donacionet, si dhe burime të tjera të ligjshme.

Në këtë kuadër, projektligji përcakton se të ardhurat nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, si dhe të ardhurat nga shitja e biletave, administrohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor. Nga këto të ardhura, 90 për qind përdoren për financimin e veprimtarisë së institucionit që i realizon, nëpërmjet buxhetit të miratuar të tij, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit. Ky

mekanizëm synon të rrisë qëndrueshmërinë financiare të institucioneve dhe mundësitë për zhvillimin e veprimtarisë së tyre artistike e kulturore.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i ndërhyrjes ligjore lidhet me përcaktimin më të qartë të destinacionit të të ardhurave që mbeten në dispozicion të institucioneve, duke përfshirë financimin e prodhimeve artistike e kulturore, repertorin vjetor dhe projektet e reja artistike, mbulimin e shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt me organizimin dhe realizimin e shfaqjeve dhe veprimtarive artistike e kulturore, shpërblimet për cilësinë artistike, promovimin e veprimtarisë, zhvillimin e audiencave, rritjen e aksesit të publikut, zhvillimin profesional dhe trajnimin e personelit, si dhe komisionimin, blerjen dhe koleksionimin e veprave të artit. Njëkohësisht, përcaktohen përgjegjësitë e drejtuesve të institucioneve për administrimin dhe përdorimin e ligjshëm, ekonomik, eficient dhe efektiv të të ardhurave, si dhe detyrimi për raportim periodik financiar dhe të veprimtarisë pranë ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, e cila monitoron realizimin, administrimin dhe përdorimin e tyre.

Në fushën e tarifave, projektligji synon të krijojë një kuadër më të qartë për shërbimet e ofruara nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përcaktuar se tarifat bazohen në koston e shërbimit dhe respektojnë parimet e proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe garantimit të aksesit të publikut në art dhe kulturë. Gjithashtu, parashikohet mundësia e aplikimit të tarifave të reduktuara ose përjashtimeve nga pagesa për kategori të caktuara përfituesish, si fëmijët, nxënësit dhe studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre, studiuesit, grupet pjesëmarrëse në veprimtari edukative, si dhe kategori të tjera të përcaktuara me legjislacion të posaçëm. Për të garantuar një zbatim të unifikuar dhe transparent, projektligji parashikon që masa e tarifave, kategoritë përfituese të reduktimit ose përjashtimit nga pagesa, si dhe rregullat dhe procedurat për zbatimin, administrimin dhe mbledhjen e tyre, të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat.

Në tërësi, ndërhyrjet e propozuara synojnë krijimin e një kuadri ligjor më funksional, gjithëpërfshirës dhe të përshtatur me nevojat aktuale të sektorit të artit dhe kulturës, duke forcuar rolin e institucioneve publike si aktorë të rëndësishëm në zhvillimin kulturor, ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar, nxitjen e krijimtarisë bashkëkohore, pasurimin e koleksioneve të artit dhe garantimin e pjesëmarrjes së publikut në jetën artistike dhe kulturore.

Në mënyrë të përmbledhur, projektligji ka për qëllim:

1. Zgjerimin dhe qartësimin e objektit, subjekteve dhe fushës së zbatimit të ligjit, duke përfshirë individët, artistët dhe profesionistët e kulturës, personat fizikë dhe juridikë, institucionet publike të artit dhe kulturës në nivel qendror dhe vendor, si dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari për promovimin dhe prezantimin e artit dhe kulturës shqiptare jashtë vendit.

2. Përditësimin e përkufizimeve ligjore dhe njohjen e formave bashkëkohore të artit dhe kulturës, nëpërmjet përcaktimit të koncepteve të artit, artistit, cilësisë artistike, fondit publik të artit dhe kulturës, kulturës, prodhimit artistik, projektit artistik, skenës së pavarur kulturore, subjektit privat që ushtron veprimtari në art dhe kulturë dhe veprës së artit.

3. Zgjerimin dhe qartësimin e fushave të veprimtarisë artistike dhe kulturore, duke përfshirë artet pamore, të aplikuara, skenike, performuese dhe muzikore, kinematografinë, krijimtarinë audiovizuale dhe digjitale, letërsinë dhe veprimtarinë botuese, veprimtaritë bibliotekare, arkivore dhe muzeore, trashëgiminë kulturore jomateriale, si dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore, kuratoriale, edukative, formuese dhe profesionale.

4. Zgjerimin e kategorive të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përfshirë shprehimisht Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, si dhe institucione të tjera publike qendrore që ushtrojnë funksione në këtë fushë, duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre.

5. Forcimin e rolit dhe funksioneve publike të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, nëpërmjet përcaktimit më të qartë të misionit të tyre, autonomisë profesionale dhe artistike, lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmit artistik, aksesit publik, transparencës, profesionalizmit, diversitetit kulturor dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit.

6. Përmirësimin e organizimit dhe qeverisjes së institucioneve, përmes qartësimit të rolit të bordeve artistike dhe organeve të tjera kolegjiale, përcaktimit të procedurave për miratimin e rregulloreve të brendshme, rishikimit të përbërjes dhe procedurës së emërimit të anëtarëve të bordeve artistike, si dhe përcaktimit të kritereve për mandatet dhe zëvendësimin e anëtarëve.

7. Reformimin e modelit të financimit të institucioneve publike të artit dhe kulturës, duke zgjeruar burimet e ligjshme të të ardhurave dhe duke përcaktuar që 90 për qind e të ardhurave nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, si dhe nga shitja e biletave, të përdoren për financimin e veprimtarisë së institucionit që i realizon, nëpërmjet buxhetit të miratuar të tij, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

8. Rritjen e mundësive për zhvillimin dhe financimin e veprimtarisë artistike e kulturore, duke përcaktuar destinacionin e përdorimit të të ardhurave për prodhime dhe projekte të reja, repertorin vjetor, shfaqjet dhe veprimtaritë artistike, shpërblimet për cilësinë artistike, zhvillimin profesional dhe trajnimin e personelit, promovimin e veprimtarisë, zhvillimin e audiencave dhe komisionimin, blerjen e koleksionimin e veprave të artit.

9. Forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë financiare, përmes përcaktimit të përgjegjësive të drejtuesve të institucioneve për administrimin dhe përdorimin e ligjshëm, ekonomik, eficient dhe efektiv të të ardhurave, detyrimeve për raportim periodik financiar dhe të veprimtarisë, si dhe monitorimit nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar e kontrollin.

10. Përcaktimin e një kuadri të qartë për tarifat e shërbimeve kulturore, duke vendosur si bazë koston e shërbimit dhe parimet e proporcionalitetit, transparencës, trajtimit të barabartë dhe aksesit të publikut, si dhe mundësinë e aplikimit të tarifave të reduktuara ose përjashtimeve nga pagesa për kategori të caktuara përfituesish. Gjithashtu, parashikohet miratimi i masave konkrete të tarifave, kategorive përfituese dhe procedurave përkatëse me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat.

11. Nxitjen e digjitalizimit, inovacionit dhe bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, duke përfshirë zhvillimin e audiencave, digjitalizimin dhe ruajtjen afatgjatë të koleksioneve, kërkimin dhe eksperimentimin artistik, bashkëprodhimet, shkëmbimet profesionale, turnetë, festivalet, rezidencat dhe promovimin e krijimtarisë shqiptare brenda dhe jashtë vendit.

12. Përcaktimin e detyrimeve për harmonizimin e statuteve dhe rregulloreve të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës me ndryshimet e

propozuara ligjore dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, brenda afatit gjashtëmujor nga hyrja në fuqi e ligjit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLGJITNË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026, me propozim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Projektligji është në përputhje me drejtimet dhe objektivat e Programit Politik të Këshillit të Ministrave 2025–2029, si dhe me Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2026–2030, në drejtim të modernizimit të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e artit dhe kulturës, forcimit të institucioneve publike, rritjes së autonomisë profesionale dhe artistike, mbështetjes së artistëve dhe zhvillimit të industrive kreative. Ndryshimet e propozuara synojnë gjithashtu përmirësimin e mekanizmave të financimit dhe administrimit financiar të institucioneve, zgjerimin e aksesit të publikut në jetën kulturore, nxitjen e krijimtarisë bashkëkohore, digjitalizimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit dhe promovimit të kulturës shqiptare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJI LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Zhvillimet e sektorit të artit dhe kulturës në Shqipëri, ndryshimet në mënyrën e krijimit, prodhimit dhe konsumimit të produkteve artistike e kulturore, si dhe zgjerimi i formave të reja të shprehjes artistike kanë bërë të nevojshëm rishikimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor ekzistues. Ligji nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, ka shërbyer si bazë për organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike të artit dhe kulturës, por përvoja e zbatimit të tij ka evidentuar nevojën për një rregullim më të plotë të sektorit, në përputhje me realitetin aktual dhe sfidat e zhvillimit kulturor.

Përparësitë e projektligjit lidhen kryesisht me krijimin e një kuadri ligjor më të qartë, gjithëpërfshirës dhe funksional për zhvillimin e artit dhe kulturës. Përditësimi i përkufizimeve ligjore, qartësimi i subjekteve dhe zgjerimi i fushave të veprimtarisë artistike dhe kulturore mundësojnë njohjen e formave të ndryshme të krijimtarisë dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm që kontribuojnë në këtë sektor, duke krijuar një bazë më të përshtatshme për hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë merr njohja e artistit, e formave të ndryshme të ushtrimit të veprimtarisë artistike dhe e skenës së pavarur kulturore, si pjesë e rëndësishme e ekosistemit artistik dhe kulturor.

Një tjetër përparësi e rëndësishme është zgjerimi dhe qartësimi i fushave të veprimtarisë artistike dhe kulturore, duke përfshirë artet pamore, të aplikuara, skenike, performuese dhe muzikore, kinematografinë, krijimtarinë audiovizuale dhe digjitale, letërsinë, veprimtaritë bibliotekare, arkivore dhe muzeore, trashëgiminë kulturore jomateriale, si dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore, kuratoriale, edukative dhe profesionale. Këto parashikime synojnë të pasqyrojnë më plotësisht diversitetin e sektorit dhe të krijojnë mundësi për zhvillimin e formave bashkëkohore dhe multidisiplinare të shprehjes artistike, duke respektuar njëkohësisht legjislacionin sektorial që rregullon fushat përkatëse.

Projektligji synon gjithashtu forcimin e institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, nëpërmjet përcaktimit më të qartë të misionit, funksioneve dhe përgjegjësive të tyre, si dhe garantimit të autonomisë profesionale dhe artistike. Përfshirja shprehimisht në këtë kuadër e Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit synon të pasqyrojë më mirë strukturën institucionale të sektorit, duke respektuar dispozitat e legjislacionit të posaçëm që rregullon organizimin dhe funksionimin e tyre. Kjo qasje synon të krijojë kushte për një veprimtari institucionale të mbështetur në profesionalizëm, lirinë e shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmin dhe diversitetin kulturor, duke rritur njëkohësisht përgjegjësinë e institucioneve ndaj publikut dhe misionit të tyre.

Një tjetër përparësi lidhet me përmirësimin e organizimit dhe qeverisjes së institucioneve publike, nëpërmjet njohjes së organeve të tjera kolegjiale me funksione këshillimore ose profesionale, krahas bordeve artistike, sipas natyrës dhe specifikës së veprimtarisë së secilit institucion. Gjithashtu, qartësimi i procedurave për miratimin e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të

brendshëm, duke respektuar rastet kur legjislacioni i posaçëm parashikon procedura të ndryshme, synon të përmirësojë efektivitetin institucional dhe të sigurojë përputhshmërinë e akteve të brendshme me kuadrin ligjor në fuqi. Përmirësimi i përbërjes dhe funksionimit të bordeve artistike, përmes përcaktimit të kritereve dhe procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve, synon të forcojë përfaqësimin profesional dhe cilësinë e vendimmarrjes.

Projektligji sjell gjithashtu përmirësime në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të institucioneve, nëpërmjet zgjerimit të burimeve të financimit dhe përcaktimit të mekanizmave më të qartë për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të krijuara nga veprimtaria e tyre. Në këtë kuadër, parashikohet që 90 për qind e të ardhurave nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe nga shitja e biletave të përdoren për financimin e veprimtarisë së institucionit që i realizon, nëpërmjet buxhetit të miratuar të tij, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit. Kjo qasje krijon premisa për rritjen e kapaciteteve prodhuese, realizimin e projekteve të reja, përmirësimin e shërbimeve kulturore dhe nxitjen e cilësisë artistike, duke forcuar njëkohësisht përgjegjshmërinë e institucioneve në administrimin e burimeve financiare.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm lidhet me përcaktimin më të qartë të destinacionit të të ardhurave që mbeten në dispozicion të institucioneve, duke përfshirë financimin e prodhimeve artistike e kulturore, repertorin vjetor, projektet e reja, mbulimin e shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt me organizimin dhe realizimin e veprimtarive, shpërblimet për cilësinë artistike, zhvillimin profesional të personelit, promovimin e veprimtarisë artistike dhe koleksionimin e veprave të artit. Njëkohësisht, parashikohen mekanizma për raportimin periodik financiar dhe të veprimtarisë, si dhe monitorimin nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë në administrimin dhe përdorimin e këtyre të ardhurave.

Në fushën e tarifave, projektligji synon të krijojë një kuadër më të qartë për shërbimet e ofruara nga institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës, duke përcaktuar parimet për përllogaritjen e tyre mbi bazën e kostos së shërbimit, proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë. Gjithashtu, parashikohet mundësia e aplikimit të tarifave të reduktuara ose përjashtimeve nga pagesa për kategori të caktuara përfituesish, si fëmijët, nxënësit dhe studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe shoqëruesit e tyre, studiuesit dhe

grupet pjesëmarrëse në veprimtari edukative, si dhe kategori të tjera të përcaktuara me legjislacion të posaçëm. Për të garantuar zbatimin e unifikuar dhe transparent të këtij mekanizmi, projektligji parashikon që masat konkrete të tarifave, kategoritë përfituese të reduktimit ose përjashtimit nga pagesa, si dhe rregullat dhe procedurat përkatëse të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat.

Problematikat që synon të adresojë projektligji lidhen me nevojën për përshtatjen e legjislacionit ekzistues me zhvillimet e sektorit dhe me kërkesat e reja të veprimtarisë artistike e kulturore. Kuadri aktual ligjor nuk pasqyron në mënyrë të plotë diversitetin e aktorëve dhe formave të krijimtarisë që operojnë sot në këtë fushë, si dhe nuk ofron në të gjitha rastet përkufizime dhe rregullime të mjaftueshme për kategoritë e ndryshme të artistëve, profesionistëve dhe subjekteve kulturore. Kjo krijon nevojën për një terminologji më të qartë, për përcaktimin e subjekteve të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit dhe për njohjen e formave të ndryshme të ushtrimit të veprimtarisë artistike e kulturore.

Një problematikë tjetër lidhet me nevojën për qartësimin e fushave të veprimtarisë dhe të funksioneve të institucioneve publike qendrore, duke marrë në konsideratë specifikat e veprimtarisë së tyre dhe legjislacionin sektorial përkatës. Përfshirja e institucioneve të tjera publike qendrore në fushën e zbatimit të ligjit kërkon një kuadër më të harmonizuar, i cili të garantojë zbatimin e dispozitave të përgjithshme të këtij ligji pa cenuar kompetencat dhe rregullimet e posaçme që lidhen me organizimin dhe funksionimin e tyre.

Gjithashtu, praktika e funksionimit të institucioneve ka evidentuar nevojën për përmirësimin e mekanizmave të organizimit dhe qeverisjes, përfshirë qartësimin e rolit të organeve kolegjiale, procedurave të miratimit të rregulloreve të brendshme dhe mekanizmave të përzgjedhjes së anëtarëve të bordeve artistike. Këto ndërhyrje synojnë të adresojnë nevojën për një përfaqësim më të mirë profesional, transparencë në proceset e emërimit dhe vazhdimësi në funksionimin e organeve përkatëse.

Një problematikë e rëndësishme lidhet edhe me administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të krijuara nga veprimtaria e institucioneve publike qendrore. Nevoja për mekanizma më të qartë të destinacionit, raportimit dhe monitorimit të këtyre

të ardhurave kërkon përcaktimin e rregullave që mundësojnë përdorimin e tyre në funksion të drejtpërdrejtë të misionit institucional, duke garantuar njëkohësisht respektimin e legjislacionit për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar e kontrollin. Po kështu, mungesa e një kuadri të unifikuar për përcaktimin dhe administrimin e tarifave të shërbimeve kulturore krijon nevojën për vendosjen e parimeve dhe procedurave të qarta, të zbatueshme për institucionet përkatëse.

Efektet e pritshme nga miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji janë krijimi i një mjedisi ligjor dhe institucional më të favorshëm për zhvillimin e artit dhe kulturës në Shqipëri. Pritet që ndryshimet e propozuara të kontribuojnë në rritjen e qartësisë ligjore, zgjerimin e fushës së zbatimit të ligjit, njohjen e formave bashkëkohore të krijimtarisë artistike dhe kulturore, si dhe përmirësimin e organizimit dhe funksionimit të institucioneve publike, forcimin e autonomisë profesionale dhe rritjen e standardeve të administrimit institucional e financiar.
Në planin artistik dhe kulturor, efektet e pritshme lidhen me zgjerimin e mundësive për krijimtarinë artistike, nxitjen e formave të reja të shprehjes artistike, mbështetjen e artistëve dhe profesionistëve të kulturës, si dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe skenës së pavarur kulturore. Gjithashtu, pritet të përmirësohen mundësitë për dokumentimin, ruajtjen, koleksionimin dhe digjitalizimin e pasurive artistike, kulturore dhe dokumentare, si dhe për zgjerimin e aksesit të publikut në koleksionet dhe shërbimet kulturore.
Në planin institucional dhe administrativ, pritet që ndryshimet të ndikojnë në përmirësimin e qeverisjes së institucioneve publike, rritjen e transparencës në funksionimin e organeve kolegjiale dhe forcimin e përfaqësimit profesional në proceset vendimmarrëse. Harmonizimi i akteve të brendshme të institucioneve me ndryshimet ligjore do të kontribuojë gjithashtu në zbatimin më të njëtrajtshëm të kuadrit rregullator dhe në qartësimin e përgjegjësive institucionale.

Në planin financiar, projektligji synon të krijojë kushte për përdorimin më efektiv të burimeve financiare, rritjen e të ardhurave që mund të përdoren në favor të veprimtarisë së institucioneve dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të financuar prodhimet dhe projektet artistike e kulturore. Përcaktimi i destinacionit të të ardhurave, raportimi periodik dhe monitorimi nga ministria përgjegjëse pritet të kontribuojnë në rritjen e transparencës, ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë financiare. Gjithashtu, përcaktimi i parimeve dhe miratimi i tarifave me vendim të Këshillit të Ministrave pritet të sigurojnë një kuadër më të unifikuar për ofrimin

dhe administrimin e shërbimeve kulturore, duke ruajtur mundësinë e aksesit të kategorive të ndryshme të publikut.

Në planin kombëtar dhe ndërkombëtar, pritet që ndryshimet të ndikojnë në forcimin e rolit të institucioneve kulturore në promovimin e identitetit dhe krijimtarisë shqiptare, zgjerimin e bashkëpunimeve dhe shkëmbimeve profesionale, zhvillimin e bashkëprodhimeve artistike dhe rritjen e prezencës së kulturës shqiptare në hapësirën kulturore ndërkombëtare.
Në përfundim, miratimi i këtij projektligji përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi më të qëndrueshëm, bashkëkohor dhe funksional të artit dhe kulturës, i cili mbështet krijimtarinë, fuqizon institucionet publike, përmirëson administrimin e burimeve financiare, nxit pjesëmarrjen kulturore dhe kontribuon në zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe identitar të vendit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është bazuar në nenin 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar", përbëhet nga 14 nene, të cilat parashikojnë ndryshime dhe shtesa në kuadrin ligjor ekzistues, me qëllim përditësimin e tij dhe përshtatjen me zhvillimet dhe nevojat aktuale të sektorit të artit dhe kulturës. Ndryshimet synojnë zgjerimin e fushës së rregullimit të ligjit, qartësimin e funksioneve të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, si dhe përmirësimin e mekanizmave të financimit dhe administrimit të burimeve të tyre. Në mënyrë më të detajuar, projektligji përmban këto ndërhyrje kryesore:

Neni 1 parashikon ndryshimin e nenit 1 të ligjit, duke riformuluar objektin e tij dhe duke zgjeruar fushën e rregullimit, përfshirë hartimin dhe zbatimin e politikave publike në fushën e artit dhe kulturës, organizimin, administrimin, funksionimin dhe financimin e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, si dhe instrumentet e mbështetjes së krijimtarisë artistike, artistëve dhe organizatave.

Neni 2 parashikon ndryshimin e nenit 3, duke përcaktuar më qartë subjektet dhe fushën e zbatimit të ligjit. Në këtë kuadër përfshihen individët, artistët dhe profesionistët e kulturës, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, institucionet publike të artit dhe kulturës, si dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari për promovimin dhe prezantimin e artit dhe kulturës shqiptare jashtë vendit. Gjithashtu, përcaktohen kushtet për përfitimin e mbështetjes dhe financimit publik nga subjektet dhe institucionet kulturore të huaja.

Neni 3 parashikon ndryshimin e nenit 4 të ligjit, duke përditësuar dhe plotësuar përkufizimet ligjore të koncepteve kryesore në fushën e artit dhe kulturës. Në këtë nen përcaktohen përkufizimet për artin, artistin, cilësinë artistike, fondin publik të artit dhe kulturës, kulturën, prodhimin artistik, projektin artistik, skenën e pavarur kulturore, subjektin privat që ushtron veprimtari në art dhe kulturë, si dhe veprën e artit.

Neni 4 parashikon shtimin e nenit 4/1, në të cilin përcaktohen fushat e veprimtarisë artistike dhe kulturore. Këto fusha përfshijnë artet pamore dhe të aplikuara, fotografinë, dizajnin, artet skenike, performuese dhe muzikore, kinematografinë, krijimtarinë audiovizuale dhe digjitale, letërsinë, veprimtarinë botuese, veprimtaritë bibliotekare, arkivore dhe muzeore, trashëgiminë kulturore jomateriale, si dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore, kuratoriale, edukative, formuese dhe profesionale. Gjithashtu, përcaktohet se këto veprimtari ushtrohen në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.

Neni 5 parashikon shtimin e institucioneve të tjera publike qendrore të artit dhe kulturës në listën e institucioneve të përfshira në ligj, përkatësisht Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit, Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, si dhe institucione të tjera publike qendrore të krijuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, përcaktohet se për institucionet organizimi dhe funksionimi i të cilave rregullohet me ligje të

posaçme, dispozitat e këtij ligji zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këto ligje.

Neni 6 parashikon ndryshimin dhe plotësimin e nenit 6 të ligjit, duke riformuluar qëllimin dhe funksionet e institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës. Në këtë kuadër, përcaktohen funksionet që lidhen me krijimin, zhvillimin, prodhimin, interpretimin, koleksionimin, dokumentimin, arkivimin, restaurimin, digjitalizimin, promovimin dhe shpërndarjen e veprave artistike e kulturore, si dhe me edukimin kulturor, zhvillimin e audiencave dhe bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar. Gjithashtu, parashikohen shprehimisht parimet e autonomisë profesionale dhe artistike, lirisë së shprehjes dhe krijimtarisë, pluralizmit artistik, aksesit publik, transparencës, profesionalizmit dhe diversitetit kulturor. Përcaktohen gjithashtu rregullat për organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve, në përputhje me aktet e krijimit, statutet, rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 7 parashikon ndryshime në nenin 7 të ligjit, lidhur me organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike të artit dhe kulturës. Ndryshimet synojnë të mundësojnë përfshirjen e organeve të tjera kolegjiale me funksione këshillimore apo profesionale, sipas statutit të institucionit dhe legjislacionit në fuqi, si dhe të përcaktojnë procedurën e miratimit të rregullores së organizimit dhe funksionimit të brendshëm.

Neni 8 parashikon plotësimin e nenit 8 të ligjit, duke zgjeruar referimin ndaj bordit artistik edhe për organet e tjera kolegjiale përkatëse, sipas funksioneve dhe përgjegjësive të përcaktuara në aktet e institucionit, duke respektuar rregullat për përbërjen, kriteret e përzgjedhjes, papajtueshmëritë dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 9 parashikon ndryshimin e pikës 3 të nenit 10 të ligjit, duke përcaktuar përbërjen dhe procedurën e emërimit të anëtarëve të bordit artistik. Bordi përbëhet nga shtatë anëtarë, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse dhe personalitete të shquara të fushës së artit ose të veprimtarive shoqërore që lidhen me të. Përcaktohet procedura e propozimit dhe emërimit të anëtarëve, detyrimi për paraqitjen e të paktën tri kandidaturave për çdo pozicion nga titullari i institucionit, papajtueshmëria e anëtarësisë me punësimin në institucionin përkatës, si dhe mandati katërvjeçar, me të drejtë riemërimi.

Neni 10 parashikon ndryshimin e nenit 12 të ligjit, duke riformuluar dhe zgjeruar burimet e financimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, si dhe duke përcaktuar rregullat për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të tyre. Në këtë nen përfshihen të ardhurat nga Buxheti i Shtetit, administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave, shfrytëzimi ekonomik i veprave artistike e kulturore, ofrimi i shërbimeve profesionale, bibliotekare, dokumentare dhe digjitale, projektet dhe programet e financimit, sponsorizimet, donacionet dhe burime të tjera të ligjshme. Një risi e rëndësishme është përcaktimi i mekanizmit të ndarjes së të ardhurave të realizuara nga administrimi dhe shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse, sipas të cilit 90 për qind përdoren në favor të institucionit që i realizon, ndërsa 10 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu, përcaktohen destinacionet e përdorimit të këtyre të ardhurave, përgjegjësitë për administrimin e tyre, mekanizmat e raportimit dhe monitorimit financiar, si dhe parimet për përcaktimin e tarifave të shërbimeve, duke parashikuar miratimin me vendim të Këshillit të Ministrave të masës së tarifave, kategorive përfituese të reduktimit ose përjashtimit nga pagesa dhe procedurave përkatëse.

Neni 11 parashikon ndryshimin e shkronjës "c" të nenit 29 të ligjit, nëpërmjet heqjes së togfjalëshit "Qendrën Kombëtare të Artit e Kulturës".

Neni 12 parashikon shtimin e dy dispozitave në nenin 35 të ligjit, duke përcaktuar afatet për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të propozuara. Konkretisht, parashikohet që ministri përgjegjës për artin dhe kulturën të miratojë, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, udhëzimin për raportimin periodik financiar dhe të veprimtarisë së institucioneve, ndërsa Këshilli i Ministrave të miratojë, brenda të njëjtit afat, vendimin për tarifat e shërbimeve dhe procedurat përkatëse.

Neni 13 parashikon një dispozitë kalimtare, sipas së cilës institucionet publike qendrore të artit dhe kulturës duhet të marrin masat për harmonizimin e statuteve dhe rregulloreve të tyre me ndryshimet e propozuara ligjore dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 14 përcakton hyrjen në fuqi të ligjit, e cila do të bëhet 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Në tërësi, përmbajtja e projektligjit synon të krijojë një kuadër ligjor më të plotë dhe funksional për sektorin e artit dhe kulturës, duke forcuar institucionet publike, përmirësuar mekanizmat e financimit dhe administrimit, zgjeruar mundësitë për zhvillimin e krijimtarisë artistike dhe garantuar një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të jetës artistike dhe kulturore në Republikën e Shqipërisë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen ministria përgjegjëse për kulturën, si dhe institucionet qendrore të Artit dhe Kulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe do t'u dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë për Administratën Publike. Gjithashtu, projektligji do të përcillet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, 'Për artin dhe kulturën', i ndryshuar", synon përmirësimin e kuadrit ligjor për financimin dhe administrimin e burimeve financiare të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, duke krijuar mekanizma më të qartë për gjenerimin, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të tyre, në funksion të përmbushjes së misionit institucional dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare.

Ndryshimet e propozuara në nenin 12 të ligjit parashikojnë zgjerimin dhe qartësimin e burimeve të financimit të këtyre institucioneve, duke përfshirë, krahas financimit nga Buxheti i Shtetit, të ardhurat nga administrimi dhe

shfrytëzimi i pasurive dhe aseteve, shitja e biletave, shfrytëzimi ekonomik i veprave artistike dhe kulturore, ofrimi i shërbimeve profesionale, bibliotekare, dokumentare dhe digjitale, financimet e përfituara nga projektet dhe programet e ndryshme, si dhe sponsorizimet dhe donacionet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Një nga risitë kryesore të projektligjit lidhet me përcaktimin e mënyrës së administrimit dhe përdorimit të të ardhurave të realizuara nga institucionet prej administrimit dhe shfrytëzimit të pasurive dhe aseteve, si dhe nga shitja e biletave. Sipas mekanizmit të propozuar, 90 për qind e këtyre të ardhurave do të përdoren në favor të institucionit që i realizon, ndërsa 10 për qind do të derdhen në Buxhetin e Shtetit. Pjesa e të ardhurave që mbetet në dispozicion të institucioneve do të përdoret për financimin e prodhimeve artistike dhe kulturore, realizimin e repertorit vjetor dhe projekteve të reja, mbulimin e shpenzimeve të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e tyre, promovimin dhe zhvillimin e audiencave, shpërblimin për cilësinë artistike, zhvillimin profesional të personelit dhe koleksionimin e veprave të artit.

Për sa i përket ndikimit në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, projektligji parashikon derdhjen në buxhet të 10 për qind të të ardhurave nga kategoritë e përcaktuara shprehimisht në dispozitën përkatëse. Ndërkohë, pjesa tjetër e këtyre të ardhurave do të përdoret në favor të institucioneve që i realizojnë, me synim mbështetjen e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së tyre dhe krijimin e mundësive për rritjen e kapaciteteve vetëfinancuese. Efekti konkret në të ardhurat buxhetore do të varet nga niveli i të ardhurave që do të realizohen nga secili institucion dhe nga zbatimi i mekanizmit të propozuar.

Në lidhje me shpenzimet buxhetore, projektligji nuk parashikon krijimin e institucioneve apo strukturave të reja administrative dhe as shtimin e drejtpërdrejtë të shpenzimeve për personel apo funksione të reja. Zbatimi i dispozitave të propozuara do të realizohet nëpërmjet strukturave ekzistuese dhe brenda kuadrit të fondeve buxhetore të miratuara për institucionet përkatëse, sipas programeve buxhetore dhe prioriteteve të përcaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe menaxhimin financiar e kontrollin.

Gjithashtu, projektligji parashikon forcimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit financiar, duke përcaktuar përgjegjësitë e drejtuesve të institucioneve

për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave, si dhe rolin monitorues të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën. Këto parashikime synojnë të garantojnë përdorimin e ligjshëm, transparent, ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale në administrimin e tyre.

Në këtë drejtim, projektligji synon të përmirësojë administrimin e burimeve financiare të institucioneve publike qendrore të artit dhe kulturës, të krijojë mundësi për rritjen e të ardhurave të tyre dhe të mbështesë zhvillimin e veprimtarisë artistike e kulturore, pa parashikuar krijimin e strukturave të reja apo shtimin e drejtpërdrejtë të shpenzimeve buxhetore. Vlerësimi përfundimtar i ndikimit në të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit do të bëhet në funksion të të dhënave financiare të institucioneve përkatëse dhe mendimit të ministrisë përgjegjëse për financat.

MINISTRI

Blendi Gonxhja